

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 9, paragrafët 1 dhe 2, 6, 13 , dhe 78 paragrafi 2 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së, nr. 275, datë 30.12.2024, në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2026, miraton këtë:

VENDIM

për miratimin e rregullave për sjelljen zgjedhore gjatë procesit të kandidimit dhe zgjedhjes së Kryetarit/es të Odës së Farmacistëve të Kosovës

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Nr. 127 Datë 06/06/26

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton rregullat e sjelljes zgjedhore gjatë procesit të kandidimit, mbledhjes së nënshkrimeve mbështetëse, fushatës zgjedhore dhe zgjedhjes së Kryetarit të Odës së Farmacistëve të Kosovës.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për kandidatët për Kryetar të OFK-së, mbështetësit e tyre, anëtarët e Kuvendit, votuesit, vëzhguesit dhe të gjithë pjesëmarrësit tjerë në procesin zgjedhor.

Neni 3

Parimet e procesit zgjedhor

Të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor janë të obliguar të veprojnë në përputhje me parimet e ligjshmërisë, barazisë, transparencës, paanshmërisë, integritetit dhe respektimit të vullnetit të lirë të anëtarëve të Kuvendit.

Neni 4

Mbështetja e kandidaturës

1. Mbështetësit e kandidatëve për Kryetar duhet të jenë anëtarë të certifikuar të Kuvendit të OFK-së për mandatin 2026–2030.
2. Çdo anëtar i Kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidat për Kryetar të OFK-së.
3. Kandidati për Kryetar nuk mund të japë nënshkrim mbështetës për vetveten.
4. Nënshkrimi mbështetës duhet të jepet me vullnet të lirë dhe pa presion, ndikim të padrejtë, kërcënim apo kushtëzim.

Neni 5

Veprimet e ndaluara

Gjatë procesit zgjedhor ndalohet:

1. Cenimi i lirisë së kandidimit, mbështetjes apo votimit;
2. Ushtrimi i presionit, ndikimit të padrejtë, kërcënimit apo kushtëzimit ndaj kandidatëve, mbështetësve, anëtarëve të Kuvendit, votuesve apo vëzhguesve;
3. Sigurimi i nënshkrimeve mbështetëse përmes mashtrimit, detyrimit apo premtimeve të përfitimeve;
4. Ofrimi i shpërblimeve apo përfitimeve për sigurimin e mbështetjes ose votës;
5. Përdorimi i gjuhës fyese, kërcënuese apo nxitëse të urrejtjes;
6. Pengimi i punës së KQZ-së apo organeve tjera përgjegjëse për administrimin e procesit;
7. Ndërhyrja në votim, numërim apo administrim të materialit zgjedhor;
8. Çdo veprim tjetër që cenon rregullsinë, barazinë, integritetin ose rezultatën e procesit zgjedhor.

Neni 6

Vëzhguesit

1. Vëzhguesit kanë të drejtë të përcjellin procesin zgjedhor vetëm në përputhje me autorizimin e dhënë.
2. Vëzhguesve u ndalohet ndërhyrja në proces, ndikimi të anëtarët e Kuvendit apo pengimi i mbarëvajtjes së procesit zgjedhor.

Neni 7

Paraqitja e ankesave

1. Çdo pretendim për shkelje të kësaj Rregulloreje duhet të paraqitet në KQZ jo më vonë se 24 orë nga momenti i pretendimit për shkelje.
2. Ankesa duhet të përmbajë përshkrimin e shkeljes së pretenduar dhe dëshmitë përkatëse, kur ato ekzistojnë.

Neni 8

Masat në rast të shkeljeve

Në rast të konstatimit të shkeljeve, KQZ-ja mund të ndërmarrë ose të iniciojë masa përkatëse, përfshirë masa etike dhe disiplinore, refuzimin ose diskualifikimin e kandidaturës nga procesi zgjedhor, si dhe iniciimin e procedurave përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Dispozita përfundimtare

Kjo Rregullore i bashkëngjitet formularit të kandidimit për Kryetar të OFK-së dhe shërben për informimin e kandidatëve, mbështetësve të tyre, anëtarëve të Kuvendit dhe vëzhguesve lidhur me rregullat e sjelljes zgjedhore gjatë periudhës zgjedhore.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i OFK-së.

Përdërgohet :

- Anëtarëve të Kuvendit
- Sekretariatit të KQZ-së

Kryetari i KQZ-së

pet
Mr.Ph. Betim Ramadani



Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

OFK - KQZ